



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 27.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.09.2023, të parashtruar nga Operatori ekonomik N.N.P. "EURO CONSTRUCTION", lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ndërtimi i çerdhes në Rogovë", me Nr. të Prokurimit: 632-23-7376-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-23-109-521, **nxjerr:**

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: N.N.P. "EURO CONSTRUCTION" e dt.19.09.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i çerdhes në Rogovë", me Nr. të Prokurimit: 632-23-7376-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-23-109-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 05.09.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 05.09.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.N.P. "EURO CONSTRUCTION" me dt.19.09.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i çerdhes në Rogovë", me Nr. të Prokurimit: 632-23-7376-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-23-109-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.09.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë të pabazuara dhe Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

